

ARGJËRIM I NDALUAR

1. Të vecuarit e një muaji, p.sh Rexhebit, për argjërimit.
2. Të agjëruarit të një dite për shkak të dyshimit, psh agjërimit të ditës së fundit të muajit Sha'baan me arsyetimin se "ndoshta ka hyrë Ramazani".
3. Ditët e Bajramit.
4. Agjërimit të ditëve të Tashriuk - me përjashtim të dikujt që kryen Haxhin, dhe nuk ka mundësi të bëjë kurban.
5. Bashkimi i dy ditëve të njëpasnjëshme të agjërimit pa e ndërprerë agjërimit në mes.

PLOTËSIMI I DITEVE TE PAARGJËRUARA

Rekomandohet që të plotësohen ditët e humbura të agjërimit menjëherë pas ditës së Bajramit. Nuk lejohet që të shtyhen ditet e humbura të agjërimit, deri në Ramazanin tjetër. Të afërmit e një personi të vdekur mund të plotësojnë ditët e humbura në emër të të ndjerit.

ZEKATI I FITRIT

Zekati i Fitrit është lëmosha e paguar nga muslimanët në fund të Ramazanit në ditën e Bajramit. Është obligim për çdo musliman që arrin muzgun e ditës së fundit të Ramazanit. Kujdestari i familjes duhet ta bëjë këtë për vete dhe për anëtarët e familjes së tij të cilët janë nën përgjegjësinë e tij. Gjithashtu rekomandohet që të dhurohet dhe në emër të fetusit në mitrën e nënës.

Urtësia e dhënjes së Zekatit të Fitrit

1. Pastron personin që sapo ka agjëruar muajin e Ramazanit nga çdo fjalim i rremë i tij.
2. Ndhmon të varfërit, në mënyrë që nevojat e tyre të përmbushen në ditën e Bajramit dhe që ata mos u kërkojnë të tjerëve.

KOHA PËR DHENIEN E ZEKATIT:

1. Koha e lejuar: Para kohës së Bajramit një ose dy ditë.
2. **Koha e rekomanduar:** Para faljes së Bajramit, pas faljes së sabahut.
3. **Koha e papranueshme:** Pas faljes së namazit të Bajramit.

Shuma për t'u dhuruar

Sasia për person është një Saa (rreth 3kg) prej ushqimit më të përdorshëm, (si drithra).Nuk është e lejuar që zekati të jepet në formën e te hollave.

FALJA E NAMAZIT TE BAJRAMIT

Ky është një detyrim individual ndaj çdo personi. Megjithatë, nëse dikush humb faljen, nuk duhet zvendësuar më pas.

KOHA E FALJES SË NAMAZIT TË BARJAMIT

Kohë në të cilën duhet të kryhet falja është pasi dielli është ngritur në lartësinë e një shtize deri në mesditë.

Vepra te Rekomanduara

1. Sipas sunetit të përgjithshëm (alejhi selam) është të falemi në një zonë të hapur dhe jo brenda një ndërtese, megjithëse është e lejuar falja brenda xhamisë.
2. Ngrerja në numër tek të hurmeve arabe, para faljes së bajramit.
3. Të bërit dush, parfumosja dhe veshja e robave më të mira.
4. Shkuarja për faljen e bajramit nga një rrugë dhe kthimi nga një rrugë tjetër.
5. Dhënja e urimit të bajramit: Takabbal Allahu minnaa wa minkum (Allahu e pranonftë për mua dhe ty).
6. Tekbiret gjatë Bajramit.
7. Thënia e tekbiereve edhe natën para Bajramit, gjithashtu dhe pas cdo namazi farz deri në perëndimin e djellit. Përshkrimi i Takbeerit:

الله أكبر ولله الحمد اله إلا الله, الله أكبر, له أكبر, الله أكبر, لا

Allahu akbar, Allahu akbar, La ilahe illaAllahu, Allahu Akbar, Allahu akbar, wa lillaahil hamd.

PËRSHKRIMI I FALJES SË BAJRAMIT

Falja është prej dy rekatesh të kryera para ligjëratës së imanit(Khutbah); Pas tekbirit të parë për të filluar faljen, gjashtë tekbiere të tjere duhen thënë. Pas kësaj fillon të recitohet surja el-Fatihah, dhe një sure tjetër sipas zgjedhjes. Pas rukuë dhe sexhdes si në cdo falje, rekati i dytë fillon me pesë tekbiere. Pas pesë tekbiereve vazhdon kryerja e rekati të dytë sic do falje tjetër der në mbylljen e faljes me dhenjën e selamit.

www.SalafiEventsUK.com

www.madeenah.com | www.attasseel-alemi.com

SHPËRNDARJE FALAS

Nëse dëshironi të ndihmoni në botimin e mëtejshëm ose në shpërndarje falas, ju lutem dërgoni email:

admin@SalafiEventsUK.com

DISPOZITAT E AGJËRIMIT ZEKATIT TË FITRIT DHE TË FITËR BAJRAMIT

Shejhi Haythem Ibn Muhamed Sahran
(Mësues pranë xhamisë së profetit, Medine)

Përkthyer nga: **Genta Myrteza**



Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit

PËRKUFIZIMI I ARGJËRIMIT (SIYAAM)

Përkufizimi gjuhësor: Të përbahesh nga diçka. **Përkufizimi islam:** Adhurimi i Allahut duke u largur prej ushqimit, pijeve dhe veprime të tjera që prishin argjerimin, nga agimi deri në përfundim të diellit.

SHTYLLAT E ARGJËRIMIT

1. Qëllimi i sinqertë (Nijeti).
2. Largimi nga cdo gjë që e prish argjerimin.

LLOJET E ARGJËRIMIT DHE NIJETI

1. Argjërimi i detyrueshëm: Kjo përfshin muajin e Ramazanit, shlyerjet dhe premtimet. Një person duhet të ketë qëllimin e argjerimit që natën para së të agjërojë, dmth para faljes së sabahut. Është e mjaftueshme për një person që të bëjë nijetin në hyrje të ramaznit. Qëllimi është në zemër, dhe shqiptimi me gojë është bid'a (risi në fe).

2. Argjërim vullnetar: Nijeti bëhet në çdo kohë të ditës, nëse personi nuk ka ngrënë ose bërë diçka që prish argjerimin. Shpërblimi për një agjërim vullnetar është në varesi të kohës kur personi bën nijetin të argjërojë.

KUSHTET E ARGJËRIMIT

- 1. Islami:** Agjërimi pranohet vetëm nga muslimanët.
- 2. Intelekti:** Një person i paaftë mendërisht nuk duhet të agjërojë.
- 3. Puberteti:** Pas moshës së pubertetit, agjërimi është detyrim. Megjithatë, një fëmijë që nuk ka arritur ende moshën e pjekurse, duhet të inkurajohet dhe të keshillohet nga kujdestari i tij/e saj, për të argjeruar.
- 4. Të jetë personi argjerues vendas;** agjërimi nuk është i detyruar për personin udhëtar, edhe pse është më mirë për të që të agjërojë sa më gjatë, nëse nuk ka veshitirs në argjërim gjatë udhëtimit. **Pse?**

Profeti (salallahu alejhi ue selam) shpesh agjëronte gjatë një udhëtimit.

Nuk do jëtë e nevojshë të plotësosh ditet e humbura të argjerimit.

Është më e lehtë të agjërosh gjatë Ramazanit.

Ftimi i virtytit të muajit të Ramazani.

5. Shëndeti: Një person i sëmurë ose i dobët nuk obligohet të agjërojë.

6. Pastërtia: Te jetë personi (femra) e pastër prej menstruacioneve dhe lehonisë.

ARGJËRIMI PËR TE SËMURIN

1. Sëmundja kronike: Një person i dobët ose i vjetër bie në këte kategori. Nuk i obligohet agjërimi në këtë gjendje. Megjithatë, për cdo ditë të pa argjeruar duhet të ushqejë një të varfër. Të varfrit i jepet ushqim në formën e miellit, orzit (ushqime të nevojshme), përafersisht 1.5kg. Është e këshillushme gjithashtu t'u japet mish dhe prej llojeve të tjera të ushqimeve të nevojshme.

2. Sëmundje e përkohshme: Femrat në periudhën e menstruacioneve, lehona, apo që ushqen femijën me gji bien në këtë kategori. Ato duhet të plotësojnë agjërimin e humbur në një datë të mëvonshme sipas numrit të ditëve të humbura.

FILLIMI I RAMAZANIT

Dallimi i hyrjes së muajit të Ramazanit mund të bëhet në dy mënyrat:

1. Me parjën e hënës së re.
2. Plotësimi i tridhjetë ditëve të muajit Sha'ban.

VEPRA TË REKOMANDUARA GJATË ARGJËRIMIT

1. Vonesa e Suhoor (vakt i ushqimit para agimit) deri në fundit të kohës së tij
2. Iftari në kohën më të hershme
3. Thyerja e agjërimit me hurma dhe ujë të freskët; nëse nuk ka mundësi atëherë me hurma të thata. Nëse nuk ka ushqim ose pije, atëherë qëllimi i Iftaarit bëhet me zemër.
4. Dua (lutja) gjatë agjërimit dhe para Iftarit.
5. Recitimi i Kur'anit, lëmosha, përpjekja për të falur faljen e natës (Taraaweeh) dhe perkuajtimi i Allahut.
6. Kryerja e Umrës.
7. Te thënurit; 'Unë jam duke agjeruar' personit që të fyen.
8. Kërkimi i natës së Kadrit (duke shtuar veprat e mira gjatë dhjetë netëve të fundit).
9. I'tikaaf (qëndrimi në xhami) gjatë dhjetë ditëve të fundit.

VEPRAT E LEJUARA GJATË ARGJËRIMIT

Është e lejuar që personi agjerues të gëlltisë pështymën, të shijojë një sasi të vogël ushqimi për shkak të nevojës (p.sh personat që gatuajnë), të bëjë dush, të përdorë miswakun, të pastrojë dhëmbët me furcë dhe të përdorë parfum.

AKTET TË CILAT PRISHIN ARGJËRIMIN

1. Ngrënja dhe pirja e qëllimshme: Nëse një person ha ose pi me haresë, ai duhet të vazhdojë agjërimin.

2. Marrëdhëniet intime: Nëse një person kryen marrëdhënie intime gjatë agjërimit të tij në ditën e Ramazanit, mbi të bie detyrimi për shlyerje me: **a.** Lirim të një skllavi.

b. Nëse nuk është në gjendje të bëjë këtë, atëherë agjërimi i dy muaj rresht.

c. Nëse nuk është në gjendje të bëjë këtë, atëherë të ushqyerit e gjashtëdhjetë të varfërve.

3. Dalja e spermës: Për shkak të prekjes, puthjes, perqafimit ose ndonjë veprim tjetër.

4. Çdo gjë e ngjashme me ngrënien ose pirjen, të tilla si marja e injeksioneve ushqyese. Sa për injeksione që nuk kanë vlerë ushqyese, ato nuk e prishin argjërimin.

5. Gjakterdhja për shkak të hixhmës. Ndersa dalja e një sasi të vogël, si gjaku për shkak të analizave të gjakut apo cdo gjë e ngjashme, nuk prish agjërimin e një personi.

6. Vjellja me dashje.

7. Menstruacionet dhe lehonija.

VEPRAT JO TË PËLQYERA GJATË ARGJËRIMIT

Këto veprime nuk e prishin agjërimin, por ato janë papëlqyeshme:

1. Shpëlarja e ekzagjeruar e gojës dhe e hundës.
2. Shijimi i sasive të vogla ushqimi pa qënë e domosdosme.

VEPRIMET E PALEJUESHME GJATË ARGJËRIMIT

Këto veprime janë të palejueshme, por nuk prishin argjërimin

1. Gëlltitja gëlbazë.
2. Një i ri që puth partneren/partnerin e tyre, pasi kjo mund të çojë në veprime të tjera.
3. Përgënjeshtrimi dhe përgojimi.
4. Sjellje e pahijshme dhe mungesë e tolerancës ndaj njerëzve të tjerë.
5. Agjërimi dy ditë radhazi pa ndërprerje të agjërimit në mes.

ARGJËRIM JO I PELQYER

Dita e premtë dhe e shtunë janë vecuar si ditë në të cilat argjerimi nuk është i pelqyeshëm. Sidoqoftë, nëse dikush argjeron një prej këtyre ditëve për shkak të një arsye të veçantë nuk ka ndonjë problem. Për shembull, nëse Dita e 'Arafës bie të shtunën është e lejueshme për të agjërohet në atë ditë.